

## **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**

**Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kz. Nr. 84/2009  
Prishtinë  
03 dhjetor 2009**

NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata Supreme e Kosovës** ka mbajtur seancën e kolegit sipas nenit 26, paragrafit (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), dhe nenit 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Për zgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK) më 24 nëntor 2009 në ndërtesën e Gjykatës Supreme në kolegin e përbërë nga gjyqtari ndërkombëtar Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegit, gjyqtarja ndërkombëtare Maria Giuliana Civinini dhe gjyqtarët Kosovar Avdi Dinaj, Osman Tmava dhe Gjuran Dema si anëtarë të kolegit.

dhe me procesmbajtësin Z. Robert Abercrombie,

nē prani tē

Prokurorit publik ndërkombëtar Theo Jacobs, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSK)

Avokatit mbrojtës Ibrahim Z. Dobruna për të pandehurin

Në lëndën penale me numër AP-KZ 393/2006 kundër të pandehurit:

Në pajtim me Aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën nr. P. Nr. 628/2004, të datës 8 mars 2007, e regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në të njëjtën ditë, i pandehuri çshëtë shpallur fajtor për veprat penale në vijim:

- [i] Për kryerjen e veprës penale **Vrasje** të s duke vepruar në bashkëpunim me dhe duke ndihmuar dhe nxitur të akuzuarit me aktakuzë të ndarë, dhe në ndërkohë dhe përfundimisht është dënuar nga Gjykata Supremë Kosovës, respektivisht në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 2, pikave (1), (3), (4) dhe (5) të Kodit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KP KSAK-së), lidhur me nenet 22 dhe 24 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative (KP RSFJ-së);
- [ii] Për kryerjen e veprës penale **Vrasje** në tentativë të duke vepruar në bashkëpunim me dhe duke ndihmuar dhe nxitur të akuzuarit me aktakuzë të ndarë, dhe në ndërkohë dhe përfundimisht është dënuar nga Gjykata Supreme Kosovës, respektivisht në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 2, pikave (1), (3), (4) dhe (5) të KP të KSAK-së, lidhur me nenet 19, 22 dhe 24 të KP të RSFJ-së;
- [iii] Për kryerjen e veprës penale **Marrëveshje** për të kryer veprën penale të vrasjes së duke vepruar në bashkëpunim me dhe duke ndihmuar ane nxitur te akuzuarit me aktakuzë të ndarë, dhe në ndërkohë dhe përfundimisht është dënuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, respektivisht t, në kundërshtim të nenit 196 të KP të KSAK-së, lidhur me nenet 22 ane 24 të KP të RSFJ-së;

#### Dhe është dënuar si në vijim:

I akuzuari është dënuar për veprën penale **Vrasje** me burgim në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) vjet [neni 37, paragrafët 1 dhe 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK-së) lidhur me nenin 30, paragrafin 2 të KP KSAK-së dhe Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59]; për veprën penale **Vrasje** në tentativë me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) vjet [neni 37, parografi 1 dhe 2 të KPPK-së lidhur me nenin 30, paragrafin 2 të Kp KSAK-së dhe Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59 dhe nenin 65, paragrafin 2 të KPPK-së]; **Marrëveshje** për të kryer veprën penale të vrasjes me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit [neni 196 KP KSAK-së]. Gjykata e shkallës së parë ka lëshuar një dënim unik prçj gjashtëmbëdhjetë (16) vitesh sipas nenit 71, paragrafit 1 dhe 2, pikës (2) të KPPK-së.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit ka paraqitur ankesë më 3 mars 2008 kundër Aktgjykit. Është pohuar se Aktgjyimi përban shkelje esenciale të procedurës penale, vërtelim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të kodit penal dhe se dënim i shqiptuar ndaj të akuzuarit do të kundërshtohet. Është propozuar të ndryshohet Aktgjyimi i kundërshtuar duke e liruar të akuzuarin nga të gjitha akuzat, të prishet Aktgjyimi dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim si dhe të ndërpritet paraburgimi i të akuzuarit.

**ZPSK-ja**, me përgjigjen e datës 2 shtator 2009 të regjistruar në shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës më 4 shtator 2009, ka kundërshtuar ankesën pjesërisht si jomeritore dhe të pabazuar. Prokurori publik vendosi ta pranojë pjesërisht ankesën dhe të ndryshoj aktgjykimin e kontestuar

- a) duke i ri-kualifikuar veprat penale të Vrasjes dhe Vrasjes në tentativë për të cilat i pandehuri është dënuar në mënyrë të drejtë;
- b) duke e liruar të pandehurin nga vepra penale Marrëveshje për të kryer vepër penale të vrasjes;

mirëpo refuzon kundërshtimet tjera të ngitura në pjesët e mbeturë të ankesës përfshirë kërkesën për lirimin e të pandehurit.

Bazuar në Aktgjykimin me shkrim në lëndën P, Nr. 628/2004 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 8 maj 2007 (e paraqitur në shkrimoren e të njëjtës gjykatë), ankesat me shkrim të dorëzuarat të të pandehurit, të dhënat relevante të dosjes dhe paraqitjet verbale të palëve gjatë seancës dëgjimore më 24 nëntor 2009, së bashku me analizën e ligjit të aplikueshëm, Gjykata Supreme e Kosovës, pas këshillimit më 3 dhjetor 2009, lëshon këtë:

## AKTGJYKIM

Sipas nenit 420, paragrafit 1, pikave 2 dhe 4, nenit 423, neneve 390, 391, dhë 392, paragrafit 1 të KPPK-së; nenit 41 të Ligjt Penal të RSFJ-së; nenit 30, paragrafëve 1 dhe 2, pikës (1), dhe paragrafit 3 të Kodit Penal të KSAK-së, dhe nenit 2, paragrafit 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) ankesa e paraqitur në emër të të akuzuarit pranohet pjesërisht dhe aktgjykimi i ankimuar ndryshohet si në vijim:

„ , i lindur më 9 në fshatin  
Urtetar i Kosovës më mështëtësi te vendbanimi i tunait ne  
- bëhet emri i nënës  
- aktualisht i paraburgosur ne  
Qendrën e Paraburgimit në Dubravë, shpal...“

## FAJTOR

Për veprat penale të pesë vrasjeve të rënda të qëllimshme dhe një vrasje të rëndë të qëllimshme në tentativë, në kundërshtim me nenin 30 paragrin 1 dhe 2, pikë (1) dhe paragrin 3 të KP KSAK në lidhje me nenin 19 dhe 22 të KP RSFJ, të zbatueshme me Rregullorën e UNMIK-ut 1999/24 (të ndëshkueshme edhe me nenin 146 dhe 147 pikat (3) dhe (11) të KPK-së), sepse ai bashkë më të tjerët morri jetën e

jetën e entoi ti merr  
në mënyrë tinëzare duke marrë pjesë aktive në krijimin e pusise

për ta dhe duke i njoftuar kryerësit e drejtpërdrejtë me telefon për atrimin e tyre te vendi i pusisë me veturën e tyre pasi ata ishin larguar nga dasma. Më parë ai i kishte siguruar kryerësit të drejtpërdrejtë tre armë AK-47 dhe një armë të huaj për të kryer krimin. 26 fishekë ( të kalibrit të pushkës 7.36 x 39) ishin shkrepur në atë velurë, duke mos arritur që të vrilet po ashtu edhe për shkak të rr Ethanave ndërrhyrëse.

Si pasojë, Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë:

### DËNIM

I akuzuari dënohet për veprën penale të Vrasjes me burgim në kohëzgjatje pesëmbëdhjetë (15) vjet [neni 38 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së lidhur me nenin 30 paragrafin 2 të KP KSAK dhe Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59]; për veprën penale të Vrasjes në tentativë me burgim në kohëzgjatje gjashtë (6) vjet [neni 38 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së lidhur me nenin 30 paragrafin 2 të KP KSAK dhe Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59 dhe Nenin 65 paragrafin 2 të KPK-së].

I Akuzuari duhet të vuaj një **dënim unik me burg prej gjashtëmbëdhjetë (16)** vitesh sipas nenit 71 par. 1 dhe 2 pikës (2) të KPK-së.

Sipas nenit 391 par. 5 të KPPK-së, dënimini përfshin kohën që i akuzuari ka kaluar në paraburgim prej datës 09 nëntor 2004 deri në dënimin me burgimin e tij të shkallës së parë të datës 08 mars 2007 dhe më tutje.

I akuzuari:

### LIROHET

nga vepra penale Marrëveshje për kryerje të veprës penale të vrasjes sipas nenit 196 të KP KSAK, në lidhje me nenin 22 dhe 24 të KP RSFJ, për të cilën ai ishte akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar PP. Nr. 526/02 të datës 31 janar 2005 dhe të regjistruar në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më 07 shkurt 2005 sepse (a) ai nuk ka kryer veprën penale të pjesëmarrjes në grup që kryen vrasje, (b) marrëvcshja për të kryer vepër penale të vrasjes nuk është më veprë penale sipas ligjit dhe (c) ai dhe kryerësit e tij nuk kanë kryer veprën penale të ndihmës dhe nxitjes së njëri tjetrit në kryerjen e asnjëres veprë penale, për të cilat ai ngarkohet.

## **SHPENZIMET**

Shpenzimet e procedurës do të mbulohen nga ankuesi bazuar në nenin 121, paragrafin 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet është i bazuar në nenin 391 par 1 pikat (6); 99; 100 paragrafin 2; 102 të KPPK-së.

## **ARSYETIMI**

### **Historia e procedurës**

1. Në mbrëmjen e 20 gushtit 2001, dhe vajzat e tij Baicë, në shtëpinë e tij festuar martesën e djemve të tyre

kane marre pjesë ne ... , e cila është motra e ... për

Familja e mbërriti në dasmë rrëth orës 18:00 dhe u larguan rrëth orës 23:00, duke udhëtuar me një veturë të kuqe përgjatë rrugës që njihet me emrin muga e urës ose mëhallë Lanit në mes fshatrave Baicë dhe Tërstenik.

Kur u afroan te ura e drurit rrëth orës 23:17, dikush ka bërtitur në gjuhën shqipe "stop" dhe apo i cili në atë kohë ishte vozitës i veturës, ka ndalur veturën, vetura u qëllua me të shtëna gruaja e tij, djali i tij, dhe vajzat e tij janë vrapë me këtë rast. Vetëm shpëtoi pusisë.

2. Bazuar në lëndën qendororë të al. (HEP Nr. 418/2002), e cila është e lidhur me kontekstin e pëershkuar, procedura hetimore kundër tjerëve ka filluar më 9 korrik 2002 dhe është zhvilluar derisa ka qenë në liri. Urdhri për arrest kundër është lëshuar më 11 korrik 2002. Hetimet kishin përfunduar dhe të pandehurit e tjerë janë akuzuar dhe gjykuar.

3. Sa i përket të pandehurve të tjerë, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës AP - KZ 393/2006, të datës 20 maj 2008, në reformim të pjesshëm të Aktgjykimit të shkallës së parç të Gjykatës së Qarkut në Gjilan në lëndën P. Nr. 162/2003, të datës 7 prill 2005, ka dënuar katër të pandehurit

për kryerjen e veprave penale të poshtës Vrasjeve të rënda dhe një Vrasje të rendë në tentativë në shkelje të nenit 30, paragrafëve 1 dhe 2, pikës (1) dhe paragrafit 3 të KP KSAK lidhur me nenet 19 dhe 22 të KP të RSFJ-së, të zbatueshëm me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 (e ndëshkueshme edhe me nenet 146, 147 pikat 3 dhe 11 lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së). Me aktgjykimin Apl.-KzL Nr. 4/2009, të datës

16 shtator 2009, duke vepruar mbi ankesën e 4 të pandehurve të lartpërmendur Gjykata Supreme përfundimisht ka vërtetuar në tërësi vendimin e shkallës së dytë.

4. I është kthyer në Kosovë në fund të vitit 2004, me qëllim që të jep dëshmi  
në emër të dhe të pandehurve të tjerë të cilët gjykoreshin për vrasjen e  
anëtarëve të familjes së është arrestuar më 9 nëntor 2004 nën  
urdhrin special të 11 korrikut 2002, dhe prej asaj kohe vazhdimi shka qenë në  
paraburgim.

5. Më 10 nëntor 2004, Gjyqtari hetues ka lëshuar një vendim për fillimin e hetimeve kundër nën dyshim të bashkëpunimit në vrasjen e [...] dhe katër anëtarëve të familjes së tij, vrasjen në tentativë të [...] vajzës së [...] , dhe marrëveshje për të kryer veprën penale të vrasjes. Gjyqtari hetues ka caktuar një muaj paraburgim për [...] i cili ka skaduar më 9 dhjetor 2004. Paraburgimi i të pandehurit [...] është shqyrtaur periodikisht dhe vazhduar prej atëherë.

6. Hetimet kundër kanë përfunduar më 10 dhjetor 2004 dhe aktakuza PP.Nr. 523/2002 është paraqitur kundër tij më 14 dhjetor 2004. Prokurori publik ndërkombëtar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën shtesë kundër tij PP.Nr. 526/2002, të datës 31 janar 2005. Aktakuza e plotësuar akuzonte të pandehurin për:

- Vrasje të duke vepruar në bashkëpunim me dhe duke ndihmuar dhe nxitur të akuzuarit me aktakuzë të ndarë, dhe në ndërkokë dhe përfundimisht është dënuar nga Gjykata Supreme Kosovës, respektivisht**

dhe , në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 2, pikave (1), (3), (4) dhe (5) të Kodit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KP KSAK-së), lidhur me nenet 22 dhe 24 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative (KP RSFJ-së);

**Vrasje në tentativë të duke vepruar në bashkëpunim me dhe duke ndihmuar dhe nxitur të akuzuarit me aktakuzë të ndarë, dhe në ndërkokë dhe përfundimisht është dënuar nga Gjykata Supreme Kosovës , respektivisht**

në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 2, pikave (1), (3), (4) dhe (5) të KP të KSAK-së, lidhur me nenet 19, 22 dhe 24 të KP të RSFJ-së;

**Marrëveshje për të kryer vepër penale të vrasjes së duke vepruar në bashkëpunim me dhe duke ndihmuar dhe nxitur të akuzuarit me aktakuzë të ndarë, dhe në ndërkokë dhe përfundimisht është dënuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, respektivisht**

në kundërshtim të nenit 196 të KP të KSAK-së, lidhur me nenet 22 dhe 24 të KP të RSFJ-së;

7. Aktakuza është konsoliduar me vendimin e Konfirmimit të gjykatës së shkallës së parë (KA Nr. 405/2004) më 31 mars 2005.

8. Me urdhrin c datës 10 qershor 2005, Kryetari i kolegjit ka caktuar fillimin e shqyrtimit gjyqësor më 29 qershor 2005 (P. Nr. 628/2004 – HEP Nr. 418/2002). Aktgjykimi dënues për vrasje, vrasje në tentativë, dhe marrëveshje për kryerjen e veprës penale është shpallur më 8 mars 2007 duke shqiptuar dënimin me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet burg, dhe me një vendim të veçantë paraburgimi i të pandehurit është vazhduar derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

9. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë ka ekzaminuar të akuzuarin Pastaj, dëshmitarët e tjerë janë marrë në pyetje: , gjithashtu edhe ata dëshmitarë të që si Polici kanë marrë pjesë gjatë marrjes në pyetje kur ka dhënë deklaratën e tij si në vijim: Polici i UNMIK-ut (Njësia Rajonale e Krimeve) ; Polici i UNMIK-ut ; Polici i UNMIK-ut ; Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) Polici , Policja e SHPK-së ; dëshmitarë nga vetë vendi i krimtit dhe konteksti i dasmës si në vijim: (motra e viktimit ; dëshmitari anonim "MB"; eksperti i balistikës ; (ai vetë pandehur në lëndën Gjilani); (vëllai i dëshmitarit a); Polici i SHPK-së ; Polici i SHPK-së ; Polici i SHPK-së ; si dhe dëshmitarët në vijim të ftuar nga mbrojtja: (i cili është i pandehur në lëndën Gjilani); (i cili është i pandehur në lëndën Gjilani); (i cili është i pandehur në lëndën Gjilani); (i cili është i pandehur në lëndën Gjilani);

10. Bazuar në këto dëshmi, gjykata e shkallës së para vërtetoi gjendjen faktike në vijim:

"Vrasësit ishin planifikuar dhe kurdisur nga , motivi i të cilit ishte hakmarrja. ka nxitur të tjerët që ta kryejnë vrasjen duke ofruar "një shumë të madhe të parave".

„, dhe të tjerët të gjithë erdhën së bashku në pasditen e 20 gushtit 2001 në çajtoren e në Drenas. arri te çajtorja dhe stoi që të dal jashtë. Ai i tha se kishte një detyrë për ata, që duhej të kryhej atë natë dhe për të cilën ai do ti paguante ata 20,000 DM. Detyra ishte vrasja e dhe familjes së tij. Pas takimit : dhe shkuan ta konfirmojnë që familja do të marrë pjesë në dasmë atë natë. (Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut P Nr. 628/2004, faqe 2 në versionin anglisht).

dhe u kthyen dhe konfirmuan që do të jetë i pranishëm në dasmë në Baicë.

Rreth orës 16:30 të gjithë u larguan nga çajtorja me veturat e tyre. Para se të shkonin i kishte dhënë një telefon mobil. Ky i fundit është dashur ta përdor telefonin për ta informuar per kohën kur do të kthehej nga dasma.

Rreth orës 21:30, i me n shkuan me veturë te ura e drurit në Baicë. Atje ata takuan he i kishte thënë se bateritë e telefonave që i kishte ai ishin të zbrazura dhe ky i fundit i kishte dhënë telefonat e dhe

i kishte thënë. të shkoi në oborrin e s ku ky i fundit do ti jepte atij armët. shkoi me veturën e tij dhe u kthye me tri AK 47 dhe një armë të huaj dhe municion për AK 47. Municioni nuk mund të përdorej për armiën e huaj. Arma e huaj ishte pushkë me dy tyta, njëra për plumba të vegjël dhe tjetra për të mëdhenj.

Rreth orës 22:00, erdhi te ura me veturën e tij Audi 80 të zezë. i kishte thënë dhe : se ai do ti priste ata në veturën e tij afér shkollës ose te autolarja dhe i kishte thënë që ai duhet të shkonte te autolarja dhe të priste një thirrje telefonike nga ai. Pastaj shkoi.

i dhe secili prej tyre morën nga një AK 47 kurse arma e huaj u la në buzë lumi. shkoi në dasmë. Ai morri me vete dy telefona mobilë. Rreth orës 22:40, thirri ... në telefonin e tij mobil dhe i tha atij se ... i dhe familja e tij ishin bërë gati të largoheshin prej dasmës. Mes orës 22:50 dhe 23:00 përafërsisht, i pa një automobil me drita ndezur duke ardhur prej Baicës duke u afruar te ura.

i tha , dhe , të mos hapin zjarr para se ai të hapte zjarr. Mu para se te kalonte urën pjesa e parme e veturës i filloj të shtinte në veturë. Menjëherë pastaj, i dhe i filluan të shtinin. Të gjithë hapen zjarr vrullshëm. Vutura u godit. Pastaj ata u ndalën së shtëni dhe u largua nga ana e tij e rrugës dhe iu bashkua i dhe

pastaj dëgjoi britmën e një vajze. Pasi dëgjoi këtë i propë filloj të qëllonte veturën. tha atij të ndalonte pasi . kishte shtënë tre, katër apo pese herë ndaras. u ndal së shiënë dhe zëri i vajzës nuk dëgjohej më. Vajza që kishte bërtitur më vonë ishte identifikuar si

pastaj thirri i në telefonin e tij mobil dhe i tha atij ti presë ata te shkolla në Gllobar. i shkoi me dy thasë, një të zi dhe një bojë bezhë, ku duhej ti kishin vendosur armët. mbante thesin e zi . tjetrin. Kurse i , dhe n shkuan ne

*drejtim të shkollës. i kaloi lumin dhe vrapi në drejtim të dasmës.  
takoi i aty dhe i tha se puna ishte kryer. pastaj i telefonoi  
he a pyeti se ku po shkonte dhe i tha se po shkonin te  
çajtorja e t për ti lënë armët dhe për të festuar. i dhe  
qëndruan në dasmë dhe më vonë u larguan.*

*Të nesërmen rreth mesditës ishte duke shkuar për të luajtur futboll. Ai  
kaloi pranë restorantit i. Aty jashtë ai pa . n, i .  
lhe i. Ai ju bashkëngiit atyre. Ata ishin duke  
biseduar se si ti ndanin shumën prej 20,000 DM që i i kishte dhënë.  
Ata po ashtu ishin duke biseduar se si të siguroheshin që askush prej atyre që  
kishin njohuri për krimin të mos fliste". (Aktgjyimi i Gjykatës së Qarkut P Nr. 628/2004,  
faqe 67 në versionin anglisht).*

11. Bazuar në të gjeturat e saj më 8 mars 2007, Gjykata e Qarkut ka shpallur aktgjykimin duke shpallur të akuzuarit fajtor për veprat penale të lartpërmendura nga pikë [i] deri në pikën [iii]. Si pasojë, Gjykata i ka shqiptuar të akuzuarit dënimet siç është specifikuar më lartë.

12. Më 10 mars 2007, avokati mbrojtës i të akuzuarit ka paraqitur paralajmërimin e ankesës të pranuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 13 mars 2007. Avokati mbrojtës i cili e kishte pranuar aktgjykimin më 21 shkurt 2008 ka paraqitur me kohë ankesë kundër atij aktgjykim më 3 mars 2008 në pajtim me nenin 398, paragrafin 1 dhe nenin 399, paragrafin 1 të KPPPK – KPPK-së.

Prokurori publik nuk është ankuar.

Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës ka paraqitur mendimin dhe propozimin e tyre të datës 2 shtator 2009 pranë kësaj gjykate më 4 shtator 2009.

13. Më 24 nëntor 2009, Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancën sipas nenit 410 të KPPK-së.

Avokati mbrojtës konfirmoi parashtresat dhe kërkesën e tij.

Prokurori publik ka vendosur që pjesërisht pa pranoj ankesën dhe ta ndryshojet aktgjykimin e kontestuar

- c) duke i ri-kualifikuar veprat penale të Vrasjes dhe Vrasjes në tentativë për të cilat i pandehuri është dënuar në mënyrë të drejtë
- d) duke e liruar të pandehurin nga vepra penale Marrëveshje për të kryer vepër penale të Vrasjes;

Mirëpo ka refuzuar kundërshtimet tjera të ngritura në pjesët tjera të ankesës përfshirë kërkesën për lirimin e të pandehurit.

## **GJETJET E GJYKATËS**

### **A. Shkeljet esenciale të dispozitave të Procedurës Penale**

#### **I. PËRBËRJA E GABUAR E KOLEGJIT TË SHKALLËS SË PARË**

14. Mbrojtja në ankesën e tij pretendon shkelje të nenit 364, paragrafit 1 pikës (1) të Ligjit mbi Procedurën Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LPP) (ekuivalent me nenin 403 paragrin 1 pikën (1) të KPPK-së për shkak të zëvendësimit të dy gjyqtarëve në kolegi, të cilët morën vendimin pa marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor. Në veçanti, kolegji fillimisht përbëhej prej Gjyqtarit ndërkombëtar Vinod Boolell si Kryetar i kolegit dhe Gjyqtarëve ndërkombëtarë Leonard Assira dhe Nurul Islam Khan si anëtarë të kolegit, të cilët gjatë procedurës përfundimisht ishin zëvendësuar me Gjyqtarët ndërkombëtarë Carol Peralta dhe Timothy James Baland. Veçanërisht ky i fundit iu bashkua shqyrtimit gjyqësor më 08 mars 2007, kur ishte shpallur Aktgjykimi, kurse gjyqtarët si tërsëi nuk ishin njoftuar rreth procedurës përderisa iu bashkëngjitet kolegit.

Përveç kësaj, edhe nen 283 i LPP-së dhe nen 323 i KPPK-së do të shkelet, pasi që gjatë procedurës nuk kishte kërkesë paraprake nga Kryetari i kolegit për Kryetarin e Gjykatës për të caktuar dy gjyqtarët zëvendësues në këtë lëndë, siç përcaktohet me dispozitat e përmendura më parë. Si pasojë e kësaj, dy gjyqtarët zëvendësues nuk kishin pasur mundësi të asistojnë në seanca para se ti bashkoheshin kolegit.

15. Gjykata Supreme e Kosovës përfundon se sipas nenit 550 të KPPK-së, KPPK-ja ishte Ligji i Procedurës Penale në fuqi në kohën e procedurës, pasi që aktakuzat kundër bashkëkryerësve tjerë tanuan ishin paraqitur në suazë të procedurës në mes të iniciimit të hetimeve më 09 korrik 2002 dhe hyrjes në fuqi të KPPPK-së/KPPK-së më 06 prill 2004, kurse i akuzuari i atë kohë ende ishte në arrati deri në arrestimin e tij më 09 nëntor 2004 i cili u bë në datës 11 korrik 2002. Për këtë arsyе procedura penale kishin filluar por nuk ishin përfunduar para hyrjes në fuqi të KPPPK-së/KPPK-së.

Sa i përket pikave të lartpërmendura të ankesës, çështja e përbërjes së duhur të kolegit të Gjykatës së shkallës së parë (neni 26, parografi 1 i KPPK-së) duhet po ashtu të hetohet *ex officio*.

16. Megjithatë, kjo pikë e ankesës është e pabazuar. Duhet të nënizohet se nen 323 i KPPK-së nuk është mandator për Kryetarin e kolegit, i cili vetëm “*mund të kërkojë nga kryetari i gjykatës të caktojë një apo dy gjyqtarë ... të paraqiten në shqyrtim gjyqësor për të zëvendësuar anëtarët e trupit gjykues*” nëse në fazën e hershme të procedurës shihet se shqyrtimi gjyqësor mund të zgjasë një kohë. Prandaj, kjo dispozitë nuk është detyruese për gjykatën dhe nuk mund të vërtetohet asnjë shkelje esenciale e kësaj pike.

Mbi përbërjen e trupit gjykues, Neni 345 paragrafi 1 i KPPK-së përcakton siç vijon:

*"Kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë fillon rishtas. Por, në rastin e tillë, trupi gjykues pas dëgjimit të paleve mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët të mos merren sërisht në pyetje dhe të mos bëhet këqyrja e re e vendit, por të lexohen deklarimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor apo të lexohet procesverbali i këqyrjes së vendit".*

Duhet të theksohet se në këtë lëndë gjatë seancës së mbajtur më 20 shkurt 2007 kolegji lajmëroi ndryshimet në përbërjen e vet dhe palët u pajtuan në bazë të nenit 345 paragrafi 1 i KPPK-së të mos merren dëshmitarët sërisht në pyetje. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se nuk kishte shkelje të dispozitave të procedurës penale me ndryshimin e përbërjes së trupit gjykues gjatë procedurës.

## II. LIRIMI I ANËTARËVE TË FAMILJES DËSHMIMIT PËRPARA GJYKATËS VJA DETYRA E

17. Avokati mbrojtës në ankesën e tij pretendon se anëtarët e familjes ishin marrë në pyetje si dëshmitarë dhe se sipas nenit 227 të LPP-së ata është dashur të shkarkohen nga detyra për të dëshmuar. Sipas ankesës, në veçanti të akuzuarit dhe në njërin anë dhe dëshmitarët janë tjetër janë vëllezër, kurse i akuzuarit është djali i axhës së të akuzuarve dhe i akuzuarit është axha i të akuzuarit dhe dëshmitari është vëllai i të akuzuarit / si dhe djali i axhës së të akuzuarve dhe

Përveç kësaj, deklaratat e të dhëna si dëshmitar më 27 gusht 2001 para Policisë në Stacionin Policor në Drenas dhe deklaratat e dëshmitarit të është dhëna gjatë hetimeve duhet të jenë të palejuara për shkak të shkeljes së nenit 229 dhe 231 të LPP-së. Asnjëri prej tyre nuk ishte paralajmëruar sipas nenit 231 paragrafit 2 të LPP-së se ata nuk ishin të obliguar ti përgjigjen pyetjeve siç parashihet me nenin 229 të LPP-së (i cili përcakton se një dëshmitar nuk obligohet tu përgjigjet pyetjeve me të cilat besohet se e ekspozon vetveten apo një familjar të afërm në ndjekje penale në kuptim të nenit 227 të LPP-së).

18. Gjykata Supreme e Kosovës pohon se lidhur me procedurat në fjalë të gjykatës, siç është thënë edhe më parë, ligji i zbatueshëm i procedurës penale çshtë KPPK-ja, kurse gjatë rrjedhës së hetimeve dispozitat e LPP-së janë të zbatueshme. Për këtë arsyesh dispozita përkatëse përlirim i dëshmitarëve nga detyra e tyre për të dhënë dëshmitarët para gjykatës është nen 160, paragrafi 1, nën-paragrafi 2 i KPPK-së. Kjo dispozitë thotë se:

*"(1) Nga detyra e dëshmimit janë të liruar: ...*

2) Personi i gjinisë së gjakut në vijë të drejtë me të pandehurin, personat e gjinisë së gjakut në vijë anësore deri në shkallë të tretë ose të gjinisë së krushqisë deri në shkallë të dytë, përveç kur procedura zbatohet për vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënim me burgim me të paktën dhjetë vjet ose ai ishte dëshmitar i veprës penale kundër fëmijës që bashkëjeton ose është i afërt me të apo me të pandehurin; ...”.

Në këtë lëndë, të gjitha krimet me të cilat i akuzuari ngarkohet janë të dënueshme me burgim që mund të arrijë maksimumin mbi dhjetë vjet. Prandaj, anëtarët e familjes së familjes nuk bien nën asnjë dispozitë ligjore mbi lirimin nga detyra e dëshmimit gjate seancave të shqyrtimit gjyqësor.

19. Po ashtu, deklaratat e dhëna veçmas nga të akuzuarit i gjatë rrjedhës së hetimeve nuk janë marrë duke shkelur nenin 227, në atë kohë të zbatueshëm, të LPP-së. Neni 227, paragrafi 1, nën- paragrafi 2 i LPP-së, që konsiderohet i rëndësishëm në këtë lëndë, përcakton si në vijim:

“(1) Nga detyra e dëshmimit janë të liruar: ...

2) Personi i gjinisë së gjakut në vijë të drejtë me të pandehurin, personat e gjinisë së gjakut në vijë anësore deri në shkallë të tretë ose të gjinisë së krushqisë deri në shkallë të dytë; ...”

Në këtë lëndë, i akuzuari a është në lidhje familjare me dëshmitarin që është babai i tij, ne snkanen e parë. Pasi a ë gjuashi i do të ishte i afërm i tij i shkallës së tretë, axhët e tij? he. janë në gjini anësore të shkallë së tretë. Megjithatë, bashkë të akuzuarit dhe janë djemtë e axhës së i biri i dhe i biri i. Prandaj, të dy këta të fundit janë në gjini në vijë anësore të shkallës së katërt me të akuzuarin. Për këtë arsyen 227 i LPP-së nuk liron dhe nga detyra e dëshmimit gjatë periudhës hetimore.

20. As neni 229 dhe 231 i LPP-së nuk janë shkelur siç pretendohet. Tani i akuzuari, më parë dëshmitar para policisë më 23 gusht 2001, ishte i njoftuar me kohë per te drejtat e tij. Kjo qartë mund të lexohet nga versioni i gjuhës shqipe të kësaj deklarate, që është e nënshkruar nën paralajmërim nga tani i akuzuari. Sa i përket deklaratave të ndryshme e të bashkë akuzuarit, Gjykata e Qarkut në Prishtinë në Aktvendimin e saj të datës 15 korrik 2005 mbi refuzimin e propozimit të Avokatit mbrojtës për të konsideruar disa dëshmi të veçanta si të palejuara, tanimë ka vërtetuar se nuk kishte arsy për të ndarë këto deklarata nga procesverbalia sipas nenit 83 të LPP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës ndan mendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, pasi që bashkë i akuzuari ishte intervistuar tri herë, më 27 gusht 2001 si dhe më 06 dhe 07 korrik 2002. Sipas procesverbalit, më 27 gusht 2001, kur u dëgjua si dëshmitar, ai ishte paralajmëruar për të drejtat e tij për të heshtur. Më 06 korrik 2002, kur u dëgjua si i dyshimtë për herë të parë, ai u paralajmërua mbi të drejtat e tij dhe në

shkresa gjendet një shënim se ai kishte nënshkruar një dokument të tillë. Së fundi, kur u morr në pyctje si dëshmitar më 07 korrik 2002, marrja në pyetje ishte bërë në praninë e avokatit të tij, Z. Nike Shala.

Sa i përket pranueshmërinë së deklaratave të të bashkë-akuzuarit i ..., të dhëna më 04 dhe 07 korrik 2002, kjo do të shtjellohet më vonë.

### III. LEJUESHMËRIA E DEKLARATAVE TË 07 QERSHOR 2002

MË 04 DHE

21. Avokati mbrojtës në kërkesën e tij ka pohuar se të dyja deklaratat e dëshmitarit dhe më vonë të bashkë-akuzuarit . janë të palejuara. Deklarata e datës 04 korrik 2002 para policisë, e cila është video incizuar, ishte dhënë pa praninë e avokatit mbrojtës, edhe pse kjo ishte e obligueshme. Edhe pse më 07 korrik 2002, kur , ishte marrë në pyetje nga Gjyqtari ndërkombëtar, ishte i pranishëm një avokat mbrojtës, deklarata nuk do të ishte dhënë si duhet, pasi që avokati mbrojtës i caktuar *sipas detyrës zyrtare* nuk do të ishte efikas për mbrojtjen e të gjitha interesat e klientit të tij. Avokati nuk i kishte bërë asnjë pyetje klientit të tij gjatë shqyrtimit e as nuk ishte konsultuar me të paraprakisht. Po ashtu ai nuk kishte parë shkresat e lëndës, para marrjes në pyetje të Prandaj, dhe për shkak se vetëm një numër i kufizuar i avokatëve mbrojtës i janë ofruar , e drejta e tij për mbrojtje të duhur i është shkelur. Si pasojë e marrjes së dy deklaratave në mënyrë të gabuar, i akuzuari ..<sup>a</sup> ishte dëmtuar po ashtu.

22. sa i përket deklaratës së dhënë më 04 korrik 2002 në polici, Gjykata Supreme e Kosovës përfundon se në shkresat e lëndës nuk mund të gjinden asnjë shënim me shkrim, duke vërtetuara kështu se ishte paralajmëruar mbi të drejtat e tij sipas nenit 67, paragrafit 1 dhc 2 dhc nenit 218, paragrafit 10 të LPP-së. Prandaj, në interes të vetë të intervistuarit pranohet konkluzioni se policët ndoshta kanë dështuar ta paralajmërojnë atë si duhet mbi të drejtat e tij dhe se ai nuk ishte në dijeni për të drejtat e tij që ti caktohet një avokat mbrojtës. Edhe pse shkresa e lëndës përmban transkriptimin me shkrim të video incizimit, përfundimi i mëparshëm duhet ti takojë edhe rastit që policët, edhe pse ishin mjaft të kujdeshëm të përfshinin prokurorin ndërkombëtar posa kuptuan cilësimin e deklaratës së dhënë, thjesht nuk arriten të marrin shënimë më shkrim rrëth aktiviteteve të tyre, posaçërisht të video incizimit. Madje edhe me këtë rast ata shkelën nenin 151, paragrafin 2 dhe nenin 87, paragrafin 4 të LPP-së. Sidoqoftë, video transkriptimi, i cili nuk përban të dhënat personale të e as është i nënshkruar fare, nuk i plotëson kushtet formale të duhura për një procesverbal zyrtar dhe prandaj nuk mund të merret si zëvendësim i tij. Kjo tashmë ishte vërtetuar nga Gjykata e shkallës së dytë në lëndën paralele të të tjerët. dhe në këtë kontekst ishte konfirmuar nga Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin apelues të datës 16 shtator 2009, API.-KZI Nr. 4/2009 (faqe 11, Nr. 18 të versionit në gjuhën angleze). Po ashtu dokumenti i heqjes dorë, i nënshkruar nga i akuzuari me qëllim të heqjes dorë nga e drejta e tij për avokat mbrojtës kurrë nuk është futur në shënimet me shkrim, që asnjëherë nuk ishte bërë në mënyrë të duhur.

Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës i konsideron deklaratat e i tē dhëna nē polici më 04 korrik 2002 si të palejuara. Prandaj, çdo diskutim i mëtutjeshëm mbi deklaratat e dhëna nga para Policisë më 4 korrik 2002 është i panevojshëm.

23. Megjithatë, ankcsa pretendon se, gjatë deklaratave të tij nē Polici, a nuk ishte i njoftuar pér të drejtat e tij, pér ekzistimin e dyshimit të bazuar dhe – prandaj i referohet nenit 364, paragrafit 1, pikës (3) të LPP-së – nuk i është dhënë ndihma e avokatit mbrojtës nē lëndën kur mbrojtja është e detynueshme. Kjo e fundit përfshin edhe të drejtën pér mbrojtje efikase, që nē këtë rast nuk ishte dhe nē mes tjerash shkel nenet 11, 67, 70 përmes 75, 168, 218 dhe 301 të LPP-së si dhe nenin 6 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Po ashtu, video incizimi ishte bërë pa autorizimin e Gjyqtarit hetues dhe prandaj shkel nenin 87 paragafin 2 të LPP-së dhe i pandehuri nuk ishte njoftuar paraprakisht pér këtë lloj të incizimit. Përveç kësaj, e tërë intervista ishte e sajtar nga Policia, ishte shtrënguar dhe mashtruar dhe po ashtu video incizimi nē një mënyrë ishte i manipuluar. Sipas ankesës, shkelja e të drejtave themelore të dëmtonte jo vetëm atë të fundit por edhe të pandehurit tjerë, nē këtë lëndë e veçanërisht të pandehurin. dhe do të kishte efekt që do të zhvlerësonë deklaratat e dhëna nga vetë para Gjyqtarit hetues, pasi që përbajtja e atyre ishte e njëjtë që tanimë ishin dhënë nē Polici.

Sa i përket ekzaminimit të shkaqeve të pa-lejueshmërisë të ndryshme nga ato që ishin pranuar nga Gjykata e parë, Gjykata Supreme e Kosovës i referohet plotësisht shtjellimeve te saja të çështjes të dhënë nē aktgjykim nē lëndën paralele dhe qendrore të tjerë, tē tjerëve tē datës 16 shtator 2009 (API.-KZI Nr. 4/2009), (faqe 11 deri 14, nr. 19 të versionit nē gjuhën angleze).

24. Sa i përket deklaratës së dhënë më 07 korrik 2002, Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron deklaratën të lejuar. Nga procesverbal mund të lexohet qartë se si i pandehur ishte i njoftuar me kohë nga ana e Gjyqtarit hetues pér akuzat kundër tij. Duhet të theksohet se kërkesa pér hetime kundër , e paraqitur më 6 korrik, përmban rezultatet e hetimeve të para (që nuk përfshinin asnjë të pandehur) dhe përbajtja e deklaratës së vctë nē polici (të cilat nē atë kohë ishte dëshmia e vetme pér të provuar akuzat kundër këtij të fundit dhe të tjerëve). Gjyqtari hetues njoftoi të akuzuarin pér të drejtat e tij pér të heshtur dhe u përgjigj se kishte dhënë deklaratë të vërtetë nē Polici dhe se është “*i gatshëm tē jep deklaratë edhe para gjyqtarit hetues*”.

Përveç kësaj, ishte prezantuar si duhet nga ana e Avokatit të tij mbrojtës Z. Fazli Balaj para Gjyqtarit hetues. Duhet të shquhet se procesverbal nuk zbulon kohën kur Z. Fazli Balaj u zgjodh pér të përfaqësuar nē shqyrtim e as kush e kishte zgjedhur atë. Pavarësisht nga fakti se ankesa pretendon se Avokati mbrojtës Fazli Balaj ishte caktuar *ex officio*, shkresat e lëndës nuk lejnë të kuptohet një gjë e tillë. Padyshim, mund të lexohet nga procesverbal se kishte pranuar avokatin, duke dhënë këtë deklaratë: “*e pranoj avokatin që më është caktuar dhe unë kam mbajtur një*

*konsultim me të para shqyrtimit*". Po ashtu as nuk diskutohet se avokati ka marrë pjesë në marjen në pyetje e të pandehurit, lhe se ka shtruar pyetje.

Veç kësaj, nga komunikimi i avokatit të njëjtë me Gjyqtarin hetues, të datës 3 gusht 2002, mund të shtjellohet se avokati kishte marrë pjesë në të gjitha shqyrtimet në lidhje me të pandehurin, kishte vizituar atë në Qendrën e Paraburgimit, ka pyetur për gjendjen e tij shëndetësore dhe ka njoftuar familjen. Avokati nuk ishte tërhequr për shkak të mungesës së profesionalizmit, siç pretendohet në ankesë, por ka hequr dorë kur babai i

e njoftoi atë se ai nuk do të mund të paguajë për shërbimet e tij si Avokat mbrojtës. Përfundimisht, asnjë keqtrajtim fizik apo psikik i të pandehurit nuk është provuar në lidhje me këtë intervistë, në të cilën nuk kanë marrë pjesë asnjë Polic.

Prandaj, çdo lloj i shkeljeve të të drejtave mbi njoftimin e të akuzuarit sipas nenit 218 të LPP-së në këtë lëndë mund të përjashtohet. Në këtë kualifikim, nuk mund të ketë asnjë konsideratë të bazuar se akuzat kundër ishin provuar vetëm me anë të deklaratave të tij të mëparshme.

Po ashtu, as vetë i ia e as Avokati i tij mbrojtës nuk kanë pohuar se nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për tu përgatitur për shqyrtim apo se kanë përjetuar pengesa tjera gjatë përgatitjes. Veç kësaj, procesverbal i dëshmon se marrja në pyetje nga Gjyqtari hetues ishte në pajtueshmëri të plotë nenin 218 të LPP-së.

#### IV. LEJUESHMËRIA E PROCESVERBALIT TË SHQYRTIMIT TË POLICIT NDËRKOMBËTAR DHE LISTËS SË THIRRJEVE ME TELEFON CELULAR

25. Avokati mbrojtës në ankesën e tij veç kësaj ka kërkuar që deklarata e Policit ndërkombëtar të UNMIK-ut, e dhënë para Gjyqtarit hetues më 06 dhe 07 gusht 2002, të ndahet nga procesverbal. Pasi që avokati mbrojtës kishte kërkuar përjashtimin e Gjyqtarit hetues dhe përjashtimin e tij nga kjo lëndë, por gjyqtari megjithatë kishte vazhduar të marrë në pyetje dëshmitarin në fjalë, nen 43 i LPP-së ishte shkelur. Aty parashihet që secili gjyqtar duhet të ndërpresë çdo veprim në çështje gjyqësore në momentin e njoftimit rrith posozimit për përjashtimin tij.

26. Ekzaminimi i dosjes mundëson të kuptohet se gjatë intervistimit të dëshmitarit Policit të UNMIK-ut më 6 gusht 2002, avokatët mbrojtës paraqitën kërkesë për përjashtimin e Gjyqtarit hetues Z. Jean Pierre Lortie sipas nenit 39 paragrafit 6 të LPP-së (faqe 12) dhe menjëherë pas kësaj braktisën procedurën hetimore, që si pasojë ishte ndërprerë. Gjyqtari hetues tha në fund të procesverbalit se kërkesa do të dërgohej te Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, kompetent për të vendosur në këtë çështje, dhe se do të vazhdojë shqyrtimin për dëshnimin e Z. n ditën vijuese më 7 gusht, për shkak të urgjencës. Ai dëshmim faktikisht ishte vazhduar ditën vijuese, pra 7 gusht. Më 11 gusht Gjyqtari hetues njoftoi avokatët mbrojtës se kërkesa për përjashtim e bazuar sipas nenit 39, paragrafi 6 LPP është "refuzuar si e papajtueshme me nenet 7 dhe 9 të Regullores së UNMIK-ut 1999/7". Kërkesa e njëjtë ishte ngritur edhe me parë dhe

ishte vendosur nga Gjykata e shkallës së parë (aktvendimet e datës 29 janar 2004 dhe 18 shkurt 2005).

Kjo Gjykatë vëren se kërkesa për përjashtim e bërë sipas nenit 39 paragrafit 6 të LPP-së është një rast unik kur gjyqtari, kudër të cilit është paraqitur kërkesa, nuk obligohet të pezullojë menjëherë të gjitha punët në këtë lëndë. Kurse neni 39 pikat 1-5 të LPP-së përshtkuajnë pengesa absolute, duke obliguar gjyqtarin që menjëherë të ndalojë të gjitha aktivitetet e tij /saj gjyqësore, neni 39 pika 6 e LPP-së është vetëm një pengesë relative për kryerjen e detyrës së gjyqtarit në lidhje me këtë lëndë (*Branko Petric, Komentet mbi Ligjin mbi Procedurën Penale 1986, botimi i dytë, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Beograd; neni 39 LPP, nr. 4. dhe 5.*). Pika 6 e këtij neni – si e vëtmja – përmban arsyen për shkarkim të cilat nuk janë as të fiksuarë e as të ilustruara dhe prandaj kanë nevojë të aprovoohen nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut, pasi që kjo lëndë është punuar nga Gjyqtari hetues ndërkombëtar. Kjo është arsyaja pse, sipas nenit 43 të LPP-së, gjyqtari, madje edhe pas paraqitjes së kërkesës për shkarkim kundër tij nën ninen 39 pikën 6 të LPP-së, ai “*derisa të merret vendimi mbi kërkesën, mund të ndërmarrë vetëm ato veprime që janë të nevojshme për të shmangur shtyrjen*”. Vetëm në rast, kur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit është e bazuar në nenen 39 pikën 6 të LPP-së, gjyqtari mund ende të ndërmarrë veprime të natyrës që nuk kanë të bëjnë me shtyrje, por nuk mund të lëshojë vendime përfundimtare. Megjithatë, këto veprime do të konsiderohen ligjërisht të vlefshme edhe nëse kërkesa për përjashtim pranohet (*Momcilo Grubac & Tihomir Vasiljevic, Komentet mbi Ligjin mbi Procedurën Penale 1982, botimi i dytë, “Savremena Administracija”, Beograd; neni 43 i LPP-së, nr. 2.*).

Në këtë lëndë, intervista e policit ndërkombëtar të UNMIK-ut nga Gjyqtari hetues ishte e natyrës urgjente, duke marrë parasysh se ky dëshmitar largohej nga misioni më 8 gusht dhe ishte e domosdoshme që ai të dëgjohej para se të largohej. Ky ishte arsyetimi i dhënë nga Gjyqtari hetues dhe duket të jetë i drejtë. Nuk ekziston asnje prctindim lidhur me vendimin për refuzimin e kërkesës për përjashtim. Prandaj, aktiviteti hetimor i kryer nga ai Gjyqtar hetues pas hedhjes poshtë të kësaj kërkesë (përfshin shqyrtimin e 14 tetor 2002) ishte i rregullt.

27. Veç kësaj, nga shkresat e lëndës mund të kuptohet se dëshmitari Z. më vonë ishte kthyer në mision nga Kaliforni dhe ishte marrë në pyetje dhe ishte marrë tërthorazi në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor të bashkë të pandehurve në lëndën paralele dhe qendrore të tjerëve në vitin 2004. Nuk kishte asnjë pretendim për pa-lejueshmëri atat e tij në gjykim.

28. sa i përket lejueshmërisë së listës së telefonatave me mobil dhe ekstraktit të kësaj liste të poseduar nga Avokati mbrojtës, ky i fundit në ankesën e tij ka kërkuar të ndahet nga shkresat e lëndës, pasi që policia i kishte marrë këto lista në mënyrë joligjore nga PTK-ja. Sipas nenit 83 të LPP-së, ato duhet të ndahan nga shkresat e lëndës; përndryshe neni 84 i LPP-së do të shkelet.

29. Kjo Gjykatë konstaton se nuk ka arsyе pёr tё shpallё listën e lartpёrmendur tё telefonatave me mobil tё palejuar pavarёsish nga fakti se listat e thirrjeve nё kёtё lёndё nuk kanё qenё tё njё rёndёsie vendimtare pёr vendimin e Gjykatёs sё shkallёs sё parё.

Nga shkrсsat e lёndёs mund tё lexohet se mё 23 nёntor 2001, bazuar nё kёrkesen e Gjyqtarit hetues, njё letёr ёshtё dёrguar nё Drejtorinё e Infrastrukturёs dhe Komunikimeve, duke kёrkuar detajet e thirrjeve hyrёse dhe dalёse lidhur me periudhёn kohore prej 19 deri 21 gusht 2001 pёr kёta 11 numra tё Valёs:

-  
-  
-  
-  
-  
-  
-  
-  
-  
-  
-

Si pёrgiigie ndaj kёsaj kёrkese, janё dhёnё detajet e kёtyre shtatё numrave:

-  
-  
-  
-  
-  
-  
-

Lista e thirrjeve prej tё cilave ёshtё bёrё pёrpilimi i eshte aerguar avvokatit mbrojtёs. Ky pёrpilim qartё tregon se detajet pasqyrojnё ato nga lista zyrtare, e cila ishte dёrguar nga PTK-ja.

Lista zyrtare e PTK-sё plotёsisht zbaton kёrkesen e Gjyqtarit hetues tё datёs 23 nёntor 2001.

#### V. MUNGESA E MOTIVIT PЁR SHKAK TЁ SHFAJЁSIMIT TЁ :

30. Pёrfundimisht, mbrojtja – nё veçanti gjatё sqarimeve tё saja verbale tё ankesёs nё seancen e datёs 24 nёntor 2009 – pretendon se nuk ka motiv pёr tё pandehurin ..  
- jё tё merr pjesё nё veprat penale me tё cilat ngarkohet, pasi qё

i cili sipas deklaratës së s kishte planifikuar dhe kishte nxitur vrasjet, duke iu ofruar vrasësve një shumë të madhe parash, ishte shfajësuar nga të gjitha akuzat përkatëse.

31. Kjo gjykatë konstaton se ky pohim nuk është i bazuar. Edhe pse nuk diskutohet fakti që së përfundit është shfajësuar me vendimin e shkallës së dytë të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 20 maj 2008 (AP-KZ 393/2008), në lëndën në fjalë nuk është detyrë e shkallës së apelit që të bëjë vlerësimin e rastit të :

Përkitazi me motivin e mundshëm të , në veçanti duhet të theksohet se motivi i krimit nuk është pjesë e vetë krimit ashtu siç përcaktohet me ligj. Krimi, sa i përket përgjegjësisë personale të kryerësit, përcaktohet vetëm me dy elemente. Si element material është sjellja e përkufizuar me kushtet e përcaktuara me dispozitat përkatëse ligjore dhe element subjektiv është qëllimi i neglizhencës së kryerësit. Ndryshe nga kjo, motivi mund të jetë i rëndësishëm për t'i kupuar të gjitha faktet e rastit dhe në veçanti prapaskenën, cila mund të na interesojë kur gjykata ta caktojë dënimin.

32. Megjithatë, përkundër kësaj nuk mund të mos përmendet që në bazë të deklaratës së dëshmitarit , të dhënë para Gjyqtarit ndërkombëtar hetues më datën 7 korrik 2009, lidhur me ndarjen e shumës prej DM20,000 në mes të kryerësve ditën e nesërme, "më vonë është thënë se : do të merrte asnjë lek, ngase tashmë kishte mjaft para" (faqe 5). Nga kjo mund të kuptohet se , kishte marrë pjesë në këtë krim pa pasur ndonjë interes monetar, prandaj roli i : t është plotësisht i parëndësishëm madje edhe qoftë për të shpjeguar motivin e mundshëm të të pandehurit.

## B. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

33. Avokati mbrojtës në ankesën e vet ka theksuar vërtetimin e gabuar dhe jo i plotë të gjendjes faktike të krimit, duke pritetnduar kështu se dëshmitë e paraqitura kundër të pandehurit s janë të fabrikuara ashtu që ekipi i policisë si dhe përfaqësuesi i prokurorisë kishin punuar së bashku dhe ashiqare kishin kurdisur dëshmitarët, në veçanti , n, nën presion. Për më tepër, nuk i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme faktit që a kishte tërhequr deklaratat e tija të mëparshme të dhëna edhe para Gjyqtarit hetues (më 11 tetor 2002) edhe gjatë shqyrimit gjyqësor. Në këtë mënyrë ishte minuar alibia e të pandehurit , i cili ishte duke kremtuar në një dasmë në kohën e kryerjes së vrasjes. Si dëshmi vërtetuese që mbështet këtë pikëpamie, në veçanti dëshmitarët , si dhe laruar në dobi të të pandehurit .

34. Gjykata e shkallës së parë, siç është theksuar më parë, mbështet aktgjykimin e saj mbi dëshmi faktike, në rend të parë në deklaratat e dhëna nga para Gjyqtarit hetues më 7 korrik 2002 dhe më 11 tetor 2002 si dhe gjatë shqyrimit gjyqësor më 1 nëntor 2005; në dëshminë e politit të UNMIK-ut , dëshminë e politit të UNMIK-ut , dëshminë e dëshmitares , deklaratën e

s; deklaratën e deklaratën e s dhe deklaratat e ekspertëve dhe dëshmitarëve të tjerë, në mesin e të cilëve ishte edhe rreth kalimit të veturave të të pandehurve para shtëpisë së tij natën kritike.

35. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se as nuk është në kompetencën e kolegjit të ankesave as nuk është e mundur faktikisht zëvendësimi i gjetjeve të gjykatës së shkallës së parë me gjetjet e veta, në veçanti pa i shqyrta rishtas të gjitha dëshmitë. Në rastin *Runjeva, Argami dhe Dema* (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZ 477/05, të datës 25 janar 2008, faqe 20), Gjykata Supreme e Kosovës në këtë kontekst ka theksuar se “*procedurat ankimore në KPPPK mbështeten në parimet sipas të cilave gjykata dëgjon, vlerëson dhe peshon dëshmitë gjatë gjykimit [...]. Për këtë arsy, nga gjykata e apelit kërkohet që t’i jep gjykatës një shkallë nderimi për arritjen e gjetjeve të saj faktike. Ajo nuk duhet që t’i ngatërrrojë gjetjet e gjykatës duke i zëvendësuar ato me të vetat, vetëm nëse dëshmitë mbi të cilat është mbështetur gjykata nuk janë të pranueshme nga çfarëdo gjykate e arsyeshme përkatëse, ku vlerësimi ka qenë ‘plotësisht i gabuar’*”.

Prandaj është rregull i kësaj gjykate që të mos shtjellojë mbledhjen e dëshmive dhe hollësitë e gjetjeve të Gjykatës së shkallës së parë.

36. Megjithatë, ka nevojë për shtjellimin e dëshmive të caktuara nga Gjykata e shkallës së parë, në veçanti lidhur me besueshmërinë e së dëshmitar dhe seriozitetin e deklaratave të tij, të kundërshtuara me këtë ankesë.

37. Sa i përket pretendimit që ka të bëjë me trysninë e tepërt dhc abuzimin fizik, referimi i është bërë asaj çfarë është shtjelluar më lart (shih pikën 22 deri në pikën 24). Nuk ka asnjë dëshmi në veçanti mbi manipulimin nga policia. Nuk ka pohime as indikacione mbi abuzim në dokumentet e ofruara në shkresat e lëndës gjatë intervistës para Gjyqtarit hetues. Për më tepër, dhe për dallim nga martja e mëhershme në pyetje nga policia e UNMIK-ut më 4 korrik 2002, asnjë polic nuk ka qenë i pranishëm kur i është paraqitur para Gjyqtarit hetues.

38. Lidhur me marrjen në pyetje nga policia e UNMIK-ut më 4 korrik 2002, rezultatet e së cilës janë krejt të papranueshme, megjithatë rishikimi i videokasetës dhe dëshmitë e policëve të pranishëm në intervistë e bëjnë të qartë se nuk ka pasur trysni të tepërt mbi të pandehurin

Policia ka regjistruar me video intervistën, me kërkesë të Prokurorit, në përputhje me kompetencat e tij për udhëheqjen e procedurave paraprake penale, për marrjen e hapave gjatë procedurës, delegimin e tyre agjencive për zbatimin e ligjit (neni 45, paragrafi 2, pikat 1, 49, 153, paragrafi 2, 155 i LPP-së), për arsyen se atëherë Gjyqtari hetues nuk kishte qenë akoma i nërfshirë në këtë pjesë të hetimeve (në fakt kërkesa për hetime kundër shtë e datës 6 korrik 2002). Pra, nuk ka pasur shkelje të dispozitivëve të LPP-së (shkelje kjo, e cila ashtu-kështu nuk sanksionohet).

Në fillim të video regjistrimit, polici kërkon nga : "flasë me zë të lartë në mënyrë që mikrofoni ta kapë zërin e tij", duke ia bërë të qartë kështu atij regjistrimin. Sa i përket informatave mbi të drejtat e tij, duhet patjetër të përkujtohet se ai të njëjtin mëngjes është lajmëruar vullnetarisht në stacionin policor, a është konsideruar ende si dëshmitar dhe vetëm pas pranimit të tij të parç lidhur me faktet, pozita e tij është ndryshuar në atë të dyshuarit. Pas këshillimit me Prokurorin, ky i fundit i ka bërë me dije policisë që ta intervistojë si të dyshuar, gjë e cila është bërë të njëjtën ditë pasdite. në veçanti nuk është arrestuar apo nuk është kapur kundër vullnetit të vet, por është lajmëruar vetë dhe ka dhënë deklaratë vullnetare. Ai nuk është shtrënguar as të paraqitet as të përgjigjet. në vazhdimësi është njofuar mbi të drejtën e tij në avokat, për ta ndalur intervistën në çfarëdo kohe dhe për të biseduar me avokatin (shih faqet 1 dhe 34 të transkriptimit të regjistrimit me video), e drejtë kjo nga e cila ai ka hequr dorë. Si arsyе për heqjen dorë nga të qenët i përfaqësuar nga avokati, ai ka sqaruar se nuk kishte dëshirë që kjo gjë të bëhet e madhe. Kjo gjë tregon po ashtu se heqja dorë ka qenë vullnetare dhe me dëshirën e tij. Akuzat kundër tij kanë qenë të bazuara në vetë deklaratat e tij dhe duhet të përkujtohet se në aktakuzë raportohet se para deklaratave të is, hetimet policore nuk kishin gjetur dëshmi të mjaftueshme për arsyetimin e akuzave. Prandaj, ai ka qenë mirë i informuar për akuzat. Deklaratat e tij ishin spontane dhe vullnetare, nga video rezulton se hetuesit kanë qenë në gjendje të formulonin pyetje për plotësim dhe sqarim, por ata nuk kishin njohuri të mëhershme mbi përfshirjen personale të të pandehurve dhe të hollësive të tjera të treguara nga

Rishikimi i videokasetës na bind mbi mungesën e çfarëdo presioni. Edhe pse intervista ka zgjatur dy orë e dy minuta, ka shkuar lehtë prej fillimit gjer në fund, duke lënë kështu përshtypje se a dhc intervistuesi i tij po flisnin nga i njëti nivel.

a qenë personalisht i lirë, i ulur në pozitë normale dhe duke pasur parasysh temat për të cilat po bëhej fjalë në deklaratën e tij, ishte goxha i relaksuar. Gjatë tërë intervistës del e qartë se dhe intervistuesi i tij janë të ulur në karrige përballë njëri tjeterit, duke biseduar në të njëjtin nivel dhe për më tepër, intervistuesi nuk ka të veshur uniformën, e cila përndryshe mbas do ta kishte irrituar apo frikësuar të intervistuarin.

i është dhënë ujë sa herë që kishte nevojë dhe sipas dëshirës së tij edhe cigare. Ai asnjëherë nuk është detyruar të përgjigjej në ndonjë pyetje dhe nuk është vendosur në ndonjë situatë të papërshtatshme.

Përashtohet mundësia e manipulimit me vetë video, ngase nuk vërehen prerje apo ndëprerje të dukshme të filmit, pastaj pyetjet dhe përgjigjet janë në vazhdimësi të lidhura në mënyrë logjike me njëra tjetrën. Koha e intervistës e deklaruar nga zyrtarët e procedurës (nga 4:08 deri në 6:10 është dy orë e dy minuta), gjë e cila përpunohet me kohëzgjatjen e tërësishme të video regjistrimit. Gjatë video intervistës, policët nuk i sugerojnë se çfarë përgjigje duhet të jepen.

39. Ankesat ngrehin dyshime rrith aftësisë mendore të is, por këto dyshime janë refuzuar bindshëm përmes aktgjykimeve në lëndën paralele dhe në atë qendrore të dhe të tjerëve (shih aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së dytë, faqe 14 dhe në veçanti aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë, faqe 99 si dhe

procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 31 janar 2005), sipas ekzaminimit të Dr. Cili përjashtoi mundësinë që ia të mund të ishte psikotik.

40. Pohimi i ankesës se rrëfimi i s ishte rezultat i fabrikimit të bërë nga policia në kuptim të tërheqjes së bërë nga shqyrtimin gjyqësor, nuk ka bazë në shkresat e lëndës.

41. Térheqjet e SHPK-sës në raport me deklaratat e tij të mëhershme të dhëna para 2002 dhe para trupit gjykuar të sësor nuk janë shkruar se ishte polici i SHPK-së ai që i kishte u rritur te gjitha qasje pasur qasje në shkresat e lëndës dhc se në këtë lëndë për herë të parë ishte përfshirë më 4 korrik 2002.

Përvec kësaj, polici i UNMIK-ut ka konfirmuar se para arrestimit të Vlora, vetëm policët ndërkombëtarë kishin një rol hetues në këtë lëndë (shqyrtimi i datës 25 gusht 2004, faqe 31). Një gjë e tillë përjashton mundësinë që që t'i t'ishte mirë i niohur me rastin dhe t'i jepje udhëzime të hollësishme lidhur me të. Për më tepër, qina ka deklaruar se në vazhdimësi i kishte dhënë udhëzime edhe gjatë ditëve në vijim deri në çastin e intervistës para Gjyqtari hetues, por n ka deklaruar se i kishte qenë me të shumicën e kohës para se të dërgohej para Gjyqtarit hetues, duke qëndruar në të njëjtën zyrë me policët ndërkombëtarë "sepse nuk mund të bëhej rehat në qeli" (faqe 13). Në këtë mënyrë, pohimi i l. : madje kishte pasur mundësinë që t'i afrohej dhe t'i jepje atij udhëzime pa u vërejtur fare nga policët e tjerë ndërkombëtarë, mund të përjashtohet.

Në intervistën e tij para Gjyqtarit hetues me datën 11 tetor 2002 (faqe 33 të versionit në gjuhën angleze), a deklaruar se kur është marrë nga Gjyqtari hetues më 7 korrik 2002, polici ndërkombëtar e ka lënë vetëm në një korridor të vogël, dhe pas kësaj kishte ardhur i dhe ia kishte freskuar kujtesën e tij se çfarë duhej t'i thoshte Gjyqtarit. Është vërtet pak e besueshme dhe shumë pak e mundur që a, duke qenë person i arrestuar, të lihet vetëm në një korridor të vogël me gjithë rrezikun që kishte mundësinë e arratisies.

Në të njëjtën intervistë (faqje 30) ishte kapur për mjekre dhe e kishte tundur anash. Në shqyrtimin gjyqësor shtuar se ishte rrahuar me shufër në shpinë. Mcgjithatë, i pyetur për të sqaruar faktin se pse kjo shufër nuk ishte përmendur në procesverbalin e intervistës para Gjyqtarit hetues, ishtë përgjigjur se në atë rast ai po ashtu kishte rrësyer këtë detaj por nuk kishte qenë në dijeni çfarë ishte shënuar në procesverbal. Ky sqarim kundërshtohet me procesverbalin e intervistës së datës 11 tetor, kur ky fakt shumë i rëndësishëm nuk përmendet, por i cili ishte nënshkruar dhe me këtë edhe konfirmuar nga. Për më tepër, përkundër faktit se i ka genë në spitalin e Qendrës së paraburgimit në Dubravë për arsyen psikologjike (shqyrtimi i

datës 11 nëntor 2003, faqe 41 i versionit në gjuhën angleze), dhe asnjë plagë nuk është gjetur në shpinën e tij nga ana e injekut, si pasojë e rrahjes së tij me shufër të pollicit.

42. Vctëm gjatë shqyrtimit gjyqësor, herë të parë ka folur për dyshimin që ato dy cigaret që iu kanë ofruar atij më 4 korrik 2002 kanë mundur të kenë përbajtur sasi të drogës. Ky pohim duket të jetë i vonuar dhe jo i besueshëm, përvç që është mohuar nga ana e dëshmitarëve dhe nga fotot e videoregjistrimit, i cili nuk tregon ndonjë sjellje "të çuditshme" apo jonormale të apo ndonjë shenjë të dhunës apo kërcënimit kundër tij.

43. a në këtë kuptim po ashtu kujton se i kishin përmendur mundësinë e shkuarjes jashtë vendit për të jetuar atje dhe lidhur me këtë ai kishte thënë se i pëlqente Anglia. Megjithatë, para Gjyqtarit hetues më datën 11 tetor 2002, a kishte deklaruar se kishte folur mbi këtë çështje edhe me një polic amerikan edhe me një tjetër shqiptar, përderisa gjatë shqyrtimit gjyqësor ai kishte mohuar se kishte pasur ndonjëherë një diskutim të tillë me policin shqiptar. Për më tepër, në shqyrtimin gjyqësor ai kishte deklaruar se nuk kishte lidhje ndërmjet diskutimit mbi Anglinë dhe të vrasjes së hetuar (shqyrtimi i datës 11 nëntor 2003, faqe 35). Asnjë dëshmi nuk e vërteton pretendimin e lhe ankesat se atij i ishte propozuar ndonjë përfitim si shkëmbim për bashkëpunimin e tij me policinë. Vetë e përjashton çfarëdo lidhje ndërmjet kësaj çështjeje se cili shtet i pëlqente dhe hetimit që po vazhdonte.

Tashmë paralel me lëndën qendrore t dhe të tjerëve, Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vërejtur pasigurinë e kur i njëjti deklaron se sugjerimet e përgatitura nga polici i SHPK- t mund të futeshin në vctëm katër faqe të formatit A4, përderisa transkriptimi i videoregjistrimit përbledh 36 (tridhjetë e gjashtë) faqe në gjubën angleze. shijelluar hollësitë e dhëna nga ina, siç është për shembull britma gjatë të shtënavë, e cila është konfirmuar nga vetë ajo, gjë kjo e cila mund të dihet vetëm nga një person që ka qenë i pranishëm në vendngjarje dhe nuk ka pasur mundësi që të sugjerohet nga ana e policisë.

44. Gjëja e fundit por jo më pak e rëndësishme është se vetë ia gjatë intervistës para Gjyqtarit hetues të datës 7 korrik 2002 (faqe 5 dhe 6 të versionit në gjuhën angleze) ka dhënë sqarimin e tij dhe për motivin e tij për të deklaruar, se ishte për hir të fëmijëve që ishin vrarë, arsyeva pse tash ai – për dallim nga deklaratat e veta të mëhershme – do ta tregonte të vërtetën para policisë dhe para Gjyqtarit hetues. Ai kishte deklaruar fjalë më fjalë: "Dy javë pas vrasjes më thirrën në stacionin policor të Gllogocit. , polic që punonte në atë stacion, më thirri përjashta stacionit policor paru se te istohesha dhe më tha: 'Kam dëgjuar se ti e din se kush e ka kryer krimin dhe nëse merresh në pyetje nga policia, më kurrë të vërtetën, sepse edhe ti edhe familja jote do ta kenë të njëjtin fat sikur. te familja e tij'. Për shkak se kisha frikë, nuk pata guxim t'ia atij them të vërtetën... ane më thirrën përsëri... më 4 korrik 2002 në polici të UNMIK-ut. ...Intervista ime këtë radhë do të registrohej me video, kështu që kësaj radhe policisë ia tregova të vërtetën. Policisë iu thashë se do t'ua tregoj të vërtetën por nga ta kërkova që të ma mbrojnë familjen. Një polic nga SHBA-ja më tha se do ta kontaktonte familjen time dhe do t'i pyeste ata nëse kishin nevojë për

*mbrojtje... Në stacionin policor erdha me dëshirën time... sepse i... për ata fëmijë që u vranë natën kritike". Ky sqarim sikur edhe sjellja e ndriçon arsyen e tërheqjes së deklaratave të tij të mëparshme të dhëna para Gjyqit të datën 11 tetor 2002 si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor.*

### C. Shkelje esenciale e Ligjit penal

45. Gjykata e shkallës së parë ka dënuar të pandehurin për krimet e Vrasjes në kundërshtim me nenin 30, paragrin 2, pikat (1), (3), (4) dhe (5) të KP të KSAK-së, lidhur me nenet 22 dhe 24 të KP të RSFJ-së dhe të Vrasjes në tentativë në kundërshtim me nenin 30, paragrin 2, pikat (1), (3), (4) dhe (5) të KP të KSAK-së, lidhur me nenet 19, 22 dhe 24 të KP të RSFJ-së.

46. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se cilësimet e sakta juridike të krimeve, për të cilat shtë dashur të dënohet, janë:

- Vrasje në kundërshtim me nenin 30, paragrin 2, pikën (1) të KP të KSAK-së, lidhur me nenin 22 të KP të RSFJ-së dhe
- Vrasje në tentativë në kundërshtim me nenin 30, paragrin 2, pikën (1) të KP të KSAK-së, lidhur me nenet 19, 22 të KP të RSFJ-së.

47. Përkitazi me krimin e Vrasjes, faktet e caktuara tregojnë se i pandehuri në mënyrë përbajtjesore ka kontribuar në kryerjen e pesë vrasjeve të qëllimshme të rënda si dhe të një vrasjeje të qëllimshme në tentativë. Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e veprës siç fjalë vjen koha dhe vendi i sulmit, numri i qitësve, lloji i armës dhe numri i fishekëve të shkrepur, nuk asnjë dyshim të arsyetuar se ka ekzistuar qëllimi në mesin e pjesëmarrësve të krimit për t'i vrarë të gjithë pasagjerët në veturën e përdorur nga familja se vetëm fati deshi që I ë shpëtonte.

48. Po ashtu nuk ka fije dyshimi se ishte rolin kryesor në kryerjen e suksesshme të këtij krimi. Ishte pikërisht ai personi që mori të tri armët (dy automatikë AK-47 dhe një pushkë të huaj) dhe municionin e përdorur për këtë pritë duke ua dhënë ato qitësve, duke përdorur veturën e saj. Ishte pikërisht ai që i lajmëroi me telefon mobil sulmuesit, për kohën kur familja është nisej nga dasma. Duke bërë një gjë të tillë, ai ka kontribuar në mënyrë përbajtjesore veprimet penale të ndërmarrë natën e 20 gushtit të vitit 2001 në cilësinë e bashkëkryerësit, siç është konstatuar tashmë edhe nga Gjykata e shkallës së parë.

49. Megjithëkëtë, në rastin në fjalë dhe në rastin e , e vetmja rrethanë rënduese e pranishme në veçoritë e saja të plota është ekzekutimi tinëzar, siç përcaktohet me nenin 30, paragrin 2, pikën 1 të KP të KSAK-së. Viktimat janë zënë në rritë dhe në besasi. Ky lloj sulmi është tinëzar nga përkufizimi dhe i pandehuri . është ka qenë në dijeni lidhur me këtë dhe në mënyrë aktive i ka kontribuar mënyries ne te cilën do të kryheshin këto krimë.

Krimet – edhe pse ndriçojnë strukturën emocionale dhc mendorc të kryerësve - nuk janë kryer në mënyrë shumë brutale (neni 30, paragrafi 2, pika (2) as të papërmbarjatur (neni 30, paragrafi 2, pika (5)), por këto krimet janë kryer asisoj për t'u siguruar se këto viktima do të vriteshin në mënvren më efikase dhe pa vuajtur më shumë se sa që duhej. Në veçanti, nuk ka dëshmi se është motivuar për këtë vrasje nga aspektet e përsitimit personal (neni 30, paragrafi 2, pika (3), pasi që sipas të akuzuarit tjetër ai nuk kishte martë fare pjesë në ndarjen e hises prej 20 000DM, duke dhënë arsyetimin e tij se “*mjaft para*”. Pasi që nuk kishte marrë pjesë në interesat e jt dhe se nuk mund se ai dinte diçka rrëth motivit të gjakmarjes se pothuara të këtij të dytit, si dhe po ashtu nuk janë plotësuar kushtet e nenit 30, paragrafi 2, pika (4).

50. Sa i përket referimit në nenin 24 të KP të RSFJ-së, sjellja e të pandehurit bie në kategorinë e nenit 22 të KP të RSFJ-së. Edhe nëse supozohet se sigurimi i armëve për krycerësit e tjerë mund <sup>ta kategorizojë</sup> sjelljen e të pandehurit si “osrim i ndihmës” (neni 24 i KP të RSFJ-së).  
Juhet që të konsiderohet si bashkëkryerës dhe në këtë mënyrë pra edhe ~~basimëpjesat e tona~~, në kuptim të nenit 22 të KP të RSFJ-së (të barasvlershëm me nenin 23 të KPK-së). Duke pasur një rol esencial pa të cilin ky krim nuk do të kishte pasur mundësi që të kryhej, pra duke iu siguruar armët dhe municionin e nevojshëm qitësve si dhe informatat e duhura lidhur me kohën e përafërt kur viktimat do t'i afroheshin pritës së organizuar, ai gjithashtu dëshironte kryerjen e krimit si krim të vetin si dhe duke ~~marrë~~ njoftuar mënyrë vullnetare. Për më tepër, një gjë e tillë hedh dritë në deklaratë <sup>ë dhënë para Gjyqtarit hetues më datën 7 korrik 2002,</sup>  
sipas të cilës <sup>na kishte</sup> dëshirë që të merrte pjesë në ~~mënyrë~~ edhe më intensive dhe të menjëzësimt, pasi që sipas asaj deklarate “arsyeja pse <sup>shtë</sup> sjellë katër armë ishte se dëshironte edhe një armë për vetën e tij” (faqe 8 e versionit në gjuhën angleze).

51. Sa i përket krimi të Marrëveshjes për të kryer veprën penale të vrasjes, sipas nenit 196 të KP të KSAK-së, i pandehuri duhet që të shfajësohet, pasi që neni 196 i KP të KSAK-së nuk ka qenë më në fuqi madje as kur Gjykata e shkallës së parë ka shpallur aktgjykimin e saj. Më 6 prill 2004, Kodi i Përkoħshem Penal i Kosovës (KPPK), i cili tash është Kod Penal i Kosovës (KPK), ka hyrë në fuqi. Dispozita më e ngjashme me këtë nen tē siperpërmendur është nen 26 i KPK-së (Bashkimi kriminal). Megjithatë, sipas ligjit tē ri, vetë marrëveshja pér të kryer veprën penale, e dënueshme me burgim prej së paku pesë vjet nuk është e mjaftueshme pér integrimin e krimtit. Tash kërkohet elementi objektiv shtesë: ndërmarrja e veprimeve përgatitore pér përbushjen e marrëveshjes. Pér këtë arsy, më nuk ekziston krimi sic përcaktohet me nenin 196 të KP të KSAK-së.

Dar më shumë roli i ; në Vrasjen e familjes he Vrasja në tentativë e  
ës si personi i vëtcm i mbijetuar i këtij sulmi, shkon shumë përtej  
nuermarrjes se "veprimeve përgatitore të realizimit" të marrëveshjes kriminale.

#### D. Vendimi mbi dënimin

52. Vendimi mbi dënimin është i drejtë. Gjykata e shkallës së parë, në përputhje me kornizën e dënimive të mundshme aktuara me ligjet përkatëse, ka caktuar për Vrasjen e pesë anëtarëve të familjes nenit 30, paragrafi 2 i KP të KSAK-së, lidhur me nenet 22 dhe 24 të KP të RSFJ-së, uespiqen e veçantë hëdhjetë (15) vjetësh, përderisa dënim i veçantë për Vrasjen në tentativë të is (neni 30, paragrafi 2 i KP të KSAK-së, lidhur me nenet 22 dhe 24 të KP te RSFJ-se) ishte gjashtë (6) vjet, ndërsa për veprën penale të Marrëveshjes për të kryer veprën penale të vrasjcs (njeni 196 i KP të KSAK-së, lidhur me nenet 22 dhe 24 të KP të RSFJ-së) një dënim të veçantë prej një (1) viti. Duke u mbështetur në këto dënimet të veçanta, është caktuar një dënim unik prej gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) vjetësh burgim, në përputhje me nenen 71, paragrafet 1 dhe 2, pikën (2) të KPPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se Gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh në mënyrë të drejtë dhe të plotë të gjitha rrethanat që ndikojnë në rëndesën e dënimit dhe ka vlerësuar drejt këto rrethana. Për këtë arsy, nuk ekziston asnjë arsy për uljen e dënimit, madje edhe pas shfajësimit të të akuzuarit nga vepra penale e Marrëveshjes për të kryer krimin e vrasjes, në kundërshtim me nenen 196 të KP të KSAK-së, lidhur me nenet 22 dhe 24 të KP të RSFJ-së, pasi që vepra penale e tillë më nuk ekziston në ligjin e ri në fuqi. Zvogëlimi i dënimit të caktuar me dënimin unik të Gjykatës së shkallës së parë tashmë është aq i fuqishëm saqë shfajësimi nga vepra penale për të cilën është caktuar dënim i veçantë prej vetëm një (1) viti, tash nuk mund të ketë asnjë efekt të dallueshëm.

Duke e pasur parasysh edhe shkallën e rrezikut shoqëror të kryerjes së veprave penale si dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, dënim i unik i këtij të fundit është caktuar në mënyrë shumë të mirë.

#### E. Vazhdimi i paraburgimit derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë

53. Avokati mbrojtës në ankesën e vet, po ashtu ka propozuar lirimin e të pandehurit nga paraburgimi. Edhe pse ky propozim varet nga Aktvendimi i veçantë, duhet të përmendet në arsyetimin e Aktgjykimit, se nuk ekziston asnjë arsy për lirimin e të pandehurit nga paraburgimi. Pikësëpari, dënim i unik mbi burgimin, tash është i formës së prerë, kështu që i akuzuari tash e tutje është në vuajtje të dënimit dhe jo nën masën e paraburgimit, siç ka qenë më herët. Pavarësisht nga ky aspekt, i pandehuri ka jetuar në : gati 10 vjet, dhe erdhi nga ky shtet kur mori pjesë në kryerjen e këtij krimi, dhe u kuiye përsëri në këtë shtet pas kryerjes së krimit. Ai është arrestuar vetëm rastësisht më datën 9 nëntor 2004, derisa po tentonte të futej në Kosovë. Për këtë arsy, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se rreziku i arratisjes është në shkallë të lartë, ashtu siç përcaktohet edhe me nenen 281, paragrafin 1, pikën (2) (i) të KPPK-së. Ky rrezik i arratisjes është konkret dhe nuk mund që të parandalohet me ndonjë masë më të butë; pasi që është bërë e qartë pas arrestimit të të pandehurit më 9 nëntor 2004, se ai kishte ardhur në Kosovë vetëm për arsy se nuk kishte ditur se kishte ndonjë urdhër për arrest të lëshuar kundër tij.

Për këto arsy, të cekura më lart, Gjykata Supreme ka vendosur sikur në dispozitiv.

Anëtar i kolegjit:

**Maria Giuliana Civinini**

Kryetar i kolegjit:

**Gerrit-Marc Sprenger**

Anëtar i kolegjit:

**Avdi Dinaj**

Anëtar i kolegjit:

**Osman Tmava**

Anëtar i kolegjit:

**Gjuran Dema**

**Këshillë juridike:**

Sipas nenit 430 të KPPK-së, nuk lejohet ankesa kundër këtij Aktgjykimi. Vetëm kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë lejohet të paraqitet dhe atë para gjykatës që ka marrë vendimin në shkallën e parë, në afat prej 3 muajsh pas dorëzimit të këtij vendimi (neni 451 – 460 i KPPK-së).